

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 8314/prot.
4

Tiranë, më 27.12.2019

UDHËZIM

Nr. 7, Datë 27.12.2019

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 10619 DATË 19.10.2018 “PËR KRIJIMIN,
ADMINISTRIMIN DHE VËNIEN NË DISPOZICION PËR PUBLIKUN TË REGJISTRIT
ELEKTRONIK PËR EKSPERTËT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të neneve 224/a, paragrafi i dytë dhe 224/d, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, dhe të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, date 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin Nr.10619 datë 19.10.2018 "Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrit elektronik për ekspertët", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

Kërkesa për regjistrim në Regjistrin Elektronik të Ekspertëve bëhet nëpërmjet portalit e-Albania.

2. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

Dokumentet e lidhura me aplikimin duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me originalin dhe dërgohen së bashku me formularin e plotësuar të kërkesës për aplikim nëpërmjet portalit e-Albania.

3. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

Për çdo aplikim të ardhur nëpërmjet portalit e-Albania krijohet dosje elektronike në të cilën ruhen dhe arkivohen kërkesa për aplikim, dokumentet shoqëruese dhe kartela e regjistrimit të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Pika 31 shfuqizohet.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ETILDA GJONAJ (SALIU)

